STS-PSA-INFO

SCHWEIZER TIERSCHUTZ STS · PROTECTION SUISSE DES ANIMAUX PSA · PROTEZIONE SVIZZERA DEGLI ANIMALI PSA

Kaninchen & Meerschweinchen / Lapins & Cobayes / Conigli & Porcellini d'India
Albanisch / Albanais / Albanese

Fletë udhëzuese mbajtja e derrave Indie dhe lepujve të butë

Jeta mesatare: Lepujt e butë dhe lepujt e butë shkurtabiq mund ti mbushin deri 12 vjet, derrat Indie deri 8 vjet.

Shpenzimet

Kafsha	60-150 CHF	Sipas asaj që a janë kafshë të tredhura
Shpenzimet fillestare	600-2000 CHF	Kafaz të përshtatshëm për kafshë, enë për ushqim dhe ujë, kasolle për çdo mot, strehimore, gypa...
Shpenzimet vjetore	afër 500 CHF	Ushqim, shpenzimet për veteriner, qëndrim në pansion për kafshë gjatë pushimeve ose përkujdesje te shtëpia
Të tjerat	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta kalojnë shumë çmimit të blerjes së kafshës.	

Derrat Indie dhe leprat e butë janë kafshë lëvizëse

Pronarët e ardhshëm duhet të informohen hollësisht tek specialistët dhe me literaturën e lëmisë para se të marrin vendim për derr Indie ose lepur të butë. Derrat Indie dhe leprat e butë nuk janë kafshë ledhatuese ose për tu ngrohur, por janë shumë të ndjeshme ndaj stresit! Mungesa për të lëvizur është arsyeja kryesore për vdekjen e derrave Indie si kafshë shtëpiake. Që ta ndien vetën mirë derrat Indie dhe leprat e butë duhet të mbahen në kafaze të mëdha, të cilat mundësojnë shumë lëvizje. Derrave Indie ju nevojiten brenda te paktën 1,5 deri 2 m² (p.sh. madhësia e kafazit për derra Indie e preferuar nga Mbrojtja Zvicërane e Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), për mbajtjen e gjatë mbarë vitit është të paktën 4 m² (p.sh. kasolle për teshtimë e preferuar nga STS bambino). Minimumi ligjorë për 2 derra Indie është ½ m² sipërfaqe tokësore. Lepujt e butë, edhe lepujt e butë shkurtabiq, nuk janë të destinuar për një mbajtje brenda në shtëpi, ngase ata aty nuk mund aplikojnë sjelljen e tyre të natyrshëm e gërmuese dhe nuk ka vend për një kafaz mjaftë të madh. Atyre u duhet me tepër se 6 m². Një kafaz duhet të përmban shumë strofka, përkatësisht kasolle e izoluara mirë dhe të ofron shumë mbulim dhe vende për fshehje. Veç kësaj ai duhet të jetë i mbrojtur dhe të ofronë hije. Një gardh i ulur nën nivel ndihmon kundër shqarthit (kunadhes) ose dhelprës grabitqare dhe kundër ikjes së lepujve të butë. Sipërfaqja minimale për mbajtjen e lepujve varët nga pesha trupore dhe përmbanë 3400 cm² (përafërsisht 50 x 70 cm) për 2 lepra shkurtabiqë deri në 2.3 kg dhe 9300 cm² për dy lepuj të mëdhej.

Derrat Indie dhe lepujt e butë janë social

Derrat Indie jetojnë në grupe hareme (një mashkull dhe disa femëra), ndërsa lepujt e butë në klanin familjar. Të dytë llojet janë kafshë shumë sociale, të cilët kanë nevojë për kafshë të llojit të njëjtë që ta ndien veten mirë. Si mbajtja e vetëm, po ashtu edhe mbajtja e një derrit Indie me një lepur të butë duhet të refuzohet, sepse këto të dy llojet kanë krejt mënyra të ndryshme të të sjellurit dhe nuk mund ta plotësojnë kafshën e llojit tjetër. Një derr Indie-mashkull i tredhur mund të mbahet më së miri me disa femra, ose mandej vetëm femra ose vetëm

meshkujt e tredhur. Lepujt e butë për shembull mund të mbahen me një mashkull të tredhur, ndërsa femrat mund të jenë mes veti shumë thumbuese.

Ku të blihen? Çka të merret parasysh?

Derrat Indie ose Lepujt e butë duhet të blihen në një shtëpi për kujdesen e kafshëve të braktisura të një organizate për mbrojtjen e kafshëve, në repartin e kafshëve brejtëse ose në një dyqan të specializuar të kopshtit zoologjik, i cili i rrit kafshët e vete në mënyrë të drejtë dhe ofron këshillim kompetent, kështu në një dyqan me etiketën e kualitetit VZFS Codex. Është me rëndësi të merret parasysh që të mos blihen lepujt e butë me tipare dalluese ekstreme (lepujt e butë shkurtabiq, lepujt e butë ankora dhe lepujt e butë shumë të vegjël, me qime shumë të gjata, me veshë shumë të mëdhej). Lepujt e butë shkurtabiq janë të pirur nga problemet e mëdha me dhëmbë. Këto probleme kërkojnë vizita dyjavore të rregullta te veterineri për mprehjen dhe lëmimin e dhëmbëve dhëmballë dhe brerës. Andaj janë më të mira rasat më të mëdha.. Edhe leshrat e gjata të derrave Indie dhe të lepujve të butë çojnë tek problemet, ngaqë gëzofi (qimet) mund të thuren und mandej duhet të shkurtohen. Kafshët me gëzof të shkurtë janë më të mira.
Hiqni dorë plotësisht nga blerja e kafshëve përmes internetit! Kafshët e ofruara përmes internetit shpesh kanë origjinën nga prodhimtaria masive dhe kultivohen (rriten) në kushte të tmerrshme të mbajtjes. Gjithashtu edhe tregtia (trafiku) ilegale me kafshë bëhet përmes shpalljeve falas në internet, dhe mashtrimet janë po ashtu prezentë.

Çka ju nevojitet derrave Indie?

Derrat Indie janë kafshë që fshihen. Në liri (hapësirë) mese 30 lloje të kafshëve grabitqare gjuajnë derrat Indie. Derrat Indie shfrytëzojnë gjithmonë të njëjtat shtigje, andaj edhe parapëlqejnë të qëndrojnë gjithmonë në afërsi të vendëve fshehëse dhe kasollave, për të fshehur shpejtë. Prandaj atyre në robëri ju nevojiten shumë mundësi për fshehje, më shumë se sa derrat në hapësirën e kufizuar: kasolla, shtëpiza prej drurit, gypa prej tapës, gypa prej dheut si dhe dëgë me gjethe të dendura si mbulesë. Aty brenda ato edhe mund të tërhiqen mbrapa prej njëri tjetrit. Këto strofka nuk bën të ngrihen lartë, përveç gjatë pastrimit të kafazit, dhe derrat Indie nuk bën të nxirren jashtë. Një gjë e tillë paraqet stres dhe vuajtje për ata. Derrat Indie janë shumë të ndjeshëm ndaj të nxehtit. Kujdes në verë me temperaturat e larta. Kurse të ftohtit në dimër nuk ju bën atyre asgjë, derisa e kanë një kafaz të madh (të paktën 4 m^2) strofkë të izoluar mirë, dhe mjaftë shoqëri të llojit të njejtë. Dimrit atyre u duhet më shumë ushqim, në veçanti farëra.

Çka ju nevojitet lepujve të butë?

Lepujt e butë shkurtabiq, të quajtur shpesh edhe lepuj xhuxh, i kanë të njëjtat nevoja si lepujt e butë. Prej mbajtjes në kotecet e zakonshëm të lepujve duhet hequr dorë urgjentisht. Aty ligen lepujt e butë, dhe kanë muskuj të tkurrur, ata nuk munden më të vrapojnë duke kërcyer sipas sojit dhe s`munden aspak të gërmojnë. Mbajtja në grupe brenda një gardhi të madh në natyrë të hapur mund të plotësoj më përpara nevojat e lepujve të butë. Kafazi i lepujve të butë duhet të jetë i pajisur patjetër me shumë strofka, kasolle të izoluara, gypa, shtëpiza dhe me nivele të ngritura.

Ushqim sipas llojit

Edhe lepujt e butë edhe derrat Indie hanë para së gjithash ushqim bimësh me shumë fije, domethënë barëra, barishte, sanë. Prandaj duhet pasur gjithmonë mjaft sanë të freskët, e jo të mykur. Ato duhet të marrin çdo ditë edhe barishte/perime (sallat, bar, bimë, perime), derrat Indie edhe pemë/fruta dhe perime të verdha, të kuqe dhe të gjelbër, perime të pasura me vitamine (p.sh. speca), se vetë nuk arrijnë ta prodhojnë vitaminin C, por duhet ta marrin me ushqim. Shumë me maturi duhet ushqyer me drithë (tagji) dhe me ushqim me shumë kalori, po ashtu edhe me bukë të fortë, se përndryshe kafshët mund të dhjamosen dhe të vdesin. Lepujt e butë dhe derrat Indie kanë një tretje shumë të ndjeshëm, për këtë arsye të mos u ndërrohet ushqimi papritmas. Për vjetërsimin e dhëmbëve janë me rëndësi gjithmonë degët e freskëta për ti ngrënë dhe prerë, degët ju shërbejnë derrave Indie edhe si mbulesë. Jo helmuese janë: bredhi i kuq, bredhi i bardh, lajthia, shelgu, ahu, mështekna, bliri, pemët frutore të pa stërpikura.

Kaninchen & Meerschweinchen / Lapins & Cobayes / Conigli & Porcellini d'India Albanisch / Albanais / Albanese

Kontrollimi i shumimit

Duhet hequr dorë nga shtimi i kafshëve, nga që vendosja e kafshëve të reja në vendet vërtet të volitshme për jetën e kafshëve është jashtëzakonisht e vështirë. Një numër i mjaftueshëm i këtyre kafshëve jetëgjata presin për një vend të mirë në shtëpitë për kujdesjen e kafshëve të braktisura dhe në stacionet e kafshëve brerëse. Meshkujt e derrave Indie dhe të lepujve të butë mund të tridhen shumë herët, në moshën disa javëshe, me përafërsisht 300 g peshë dhe menjëherë të integrohen prapë në grup. Veterinerët dhe veterineret ju këshillojnë me gjithë qejf mbi tredhjen e hershme dhe tredhjen (kastrimin), një ndërhyrje kirurgjike, e cila bëhet nën narkozë.

Kafshët dhe pushimet

Derrat Indie të ndjeshëm ndaj stresit dhe lepujt e butë rrinë më së miri në kafazet e tyre te shtëpia, ushqehen dhe mirëmbahen prej një personi të specializuar dhe të besueshëm. Ata mund të strehohen si alternativë, në një pansion për kafshë ose në një shtëpi për kujdesjen e kafshëve të braktisur, gjë që kushton 15-30 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është e ndaluar me ligj dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 20 000 franga.

Derrat Indie, lepujt e butë dhe fëmijët

Derrat Indie të mbajtura sipas llojit përkatës dhe lepujt e butë ofrojnë mundësi tepër tërheqëse vrojtimi për fëmijë. Një i rritur duhet megjithatë të merr përgjegjësinë, ti udhëzon dhe mbikëqyr fëmijët në sjelljen dhe mirëmbajtje e tyre ndaj kafshëve. Megjithëse derrat Indie po ashtu edhe lepujt e butë lehtë zbuten, ato nuk janë kafshë për tu ngrohur. Ato nuk janë të përshtatshëm që të barten me vete, të përqafohen ose të ledhatohen. Meqenëse derrat Indie nuk mbrohen, shpesh supozohet që ato e shijojnë atë çast, por në të vërtetë ky është një stres i madh dhe nganjëherë edhe torturim i vërtetë i kafshëve. Më parë mbrohen lepujt e butë, por edhe ata nuk dëshirojnë të ngrihen nga toka.

Informacionet dhe vendet për kontakt

- „Meerschweinchen" (derrat Indie), „Kaninchen und Zwergkaninchen" (lepujt e butë dhe lepujt e butë shkurtabiq) (gjermanisht, frëngjisht, italisht) „Prospekt artgerechte Gehege" (Prospekte kafaze sipas llojit), fletë udhëzuese falas të Mbrojtje Zvicërane të Kafshëve STS (Schweizer Tierschutz STS), Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, Postfach, 4008 Basel, Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, sts@tierschutz.com, www.tierschutz.com, këshillim falas (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), broshura falas, adresat e strehimoreve për kafshë, klubi i fëmijëve www.krax.ch.
- Broshura "„Meerschweinchen – Tiere richtig halten" (derrat Indie - mbajtja e duhur e kafshëve) dhe "Kaninchen Tiere richtig halten" (lepujt - mbajtja e duhur e kafshëve) (gjermanisht, frëngjisht, italisht), botuar nga Enti Federal i Veterinës BVET. Mund të porositët falas ose të shkarkohet në formatin PDF nga BVET, www.bvet.admin.ch dhe www.tiererichtighalten.ch.
- Gardhi (kafazi) i duhur sipas llojit për derra Indie dhe lepuj të butë, p.sh. kasolla bambino, e cila munt të blihet nga www.kleintierstaelle.ch.
- Libra të rekomanduar: Artgerechte Haltung – ein Grundrecht auch für Meerschweinchen" (mbajtje sipas llojit – një e drejtë themelore edhe për derra Indie) dhe „Artgerechte Haltung – ein Grundrecht auch für (Zwerg-)Kaninchen" (mbajtje sipas llojit – një e drejtë themelore edhe për lepujt e butë-shkurtabiq), nga Ruth Morgenegg , secila nga 34.– franga, , shtëpia botuese Kaufmann.
- Telefoni këshillues për derrat Indie dhe lepujt e butë dhe ndërmjetësimi i kafshëve Ruth Morgenegg, Tel. 0900 57 52 31 (2.13 franga në minutël, gjermanisht)

Redaktor:
Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com